



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT

PROGRAMI I ZHVILLIMIT PROFESIONAL
PËR MARRJEN E SHKALLËVE TË KUALIFIKIMIT TË MËSUESVE
TË LËNDËS “GJEOGRAFI”
2018

1. HYRJE

Aftësia e mësuesve për ta bërë arsimimin e nxënësve, “preokupimin” kryesor të ditës, kërkon përkushtim, përgjegjshmëri dhe standarde të larta në punë dhe sjellje. Mësuesit veprojnë me ndershmeri dhe integritet, kanë njohuri të forta përmbajtësore, përdorin dijet dhe aftësitë e tyre, por në të njëjtën kohë përditësojnë njohuritë nëpërmjet vetëvlerësimeve të vazhdueshme, krijojnë marrëdhënie pozitive profesionale dhe punojnë me prindërit në interesin më të mirë të nxënësve të tyre.

Programi i zhvillimit profesional për efekt marrjen e kategorive të kualifikimit të mësuesve të lëndës së Gjeografisë është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA) për t’u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së Gjeografisë në përgatitjen për testimin kombëtar për marrjen e kategorive të kualifikimit si dhe të gjitha Drejtorive Arsimore Rajonale dhe Zyrave Arsimore për të organizuar zhvillimin profesional për të gjithë mësuesit që do të hyjnë në këtë proces.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që MASR ka vendosur për mësuesit që kualifikohen. Programi është hartuar duke mbajtur parasysh se fushat kryesore në të cilat testohen njohuritë dhe aftësitë e mësuesve janë:

- Dokumentacioni zyrtar¹ shkollor, i cili ka të bëjë me veprimtarinë e mësimdhënësve dhe edukative të mësuesve në shkollë.
- Programe lëndore të gjeografisë.
- Aspekte të pedagogjisë, metodologjisë dhe përdorimit të TIK-ut në mësimdhënie-nxënie.
- Aspekte të etikës dhe të komunikimit.
- Aspekte të drejtshkrimit të gjuhës shqipe.
- Përmbajtja shkencore e lëndës, sipas programeve lëndore përkatëse.

¹Dokumentet ligjore, urdhëresat dhe udhëzimet e MASR-së që zbatohen në shkollë duke u përqendruar në ato të viteve të fundit.

2. QËLLIMI I PROGRAMIT

Qëllimi i hartimit të programit të zhvillimit profesional të mësuesve për efekt kualifikimi është:

- të ofrojë një program orientues për t'u ardhur në ndihmë të gjithë mësuesve të lëndës së Gjeografisë në arsimin parauniversitar për të realizuar veprimtaritë kualifikuese dhe trajnuese, si dhe DAR/ZA-ve, për të organizuar zhvillimin profesional të mësuesve. Në këtë aspekt programi mund të plotësohet nga DAR/ZA-të përkatëse, sipas kushteve dhe mundësive konkrete;
- të ofrojë një program të detyruar, për mësuesit që këtë vit do të marrin kategoritë e kualifikimit, në mënyrë që ata të realizojnë një përgatitje, për të përballuar me sukses kërkesat që ka testimi kombëtar.

Programi synon që mësuesi:

- të njohë dhe zbatojë legjislacionin arsimor e në mënyrë të veçantë risitë më të fundit të reformës arsimore;
- të zotërojë kompetencat profesionale të kuadrit mësimdhënës, për të ndikuar drejtpërdrejtë në efektivitetin e procesit mësimor, për një mësimdhënie të suksesshme;
- të demonstrojë aftësitë në fushën pedagogjike për përzgjedhjen e modeleve për organizimin e klasës, për shtjellimin e koncepteve, për nxitjen e diskutimeve, për përdorimin e teknikave të vlerësimit të nxënësve etj.;
- të tregojë përgjegjshmëri në njohjen e koncepteve bazë dhe ligjësive shkencore të lëndës, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë, në përputhje me specifikat e moshës së nxënësve dhe të klasës ku japin mësim;
- të demonstrojë zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre në shkollë;
- të zotërojë zbatimin e rregullave drejtshkimore të gjuhës shqipe gjatë procesit të mësimdhënie –nxënies;
- të përdorë aftësitë e TIK-ut, si një nga risitë më të fundit në mësimdhënien bashkëkohore.

3. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për të qenë lehtësisht i përdorshëm, programi është paraqitur sipas një formati të caktuar. Për secilën fushë, përcaktohen:

- kompetencat profesionale, si dhe rezultatet e pritshme për realizimin e këtyre kompetencave;

- literatura përkatëse rekomanduese në funksion të përvetësimit të kompetencave të fushës. Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e secilës fushë të testimit, do ta ndihmojnë mësuesin që të identifikojë çështjet në të cilat duhet të përqendrohet.

FUSHA : DOKUMENTACIONI ZYRTAR SHKOLLOR	
Kompetenca	Literatura e rekomanduar
<p style="text-align: center;">Zbatimi me përgjegjshmëri i kërkesave të legjislacionit dhe dokumentacionit shkollor</p>	
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe dispozitat normative të këtij sistemi; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për hartimin dhe zbatimin e kurrikulës shkollore; • zbaton legjislacionin, udhëzimet dhe rregulloret për personelin e shkollës; • demonstroi zbatimin konkret të udhëzimeve të MASR, në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënie-nxënies; • zbaton etikën profesionale të mësuesit; • respekton të drejtat dhe liritë e nxënësit; • respekton detyrat, të drejtat dhe liritë e mësuesit; • zbaton rregulloret dhe udhëzimet për zhvillimin profesional të mësuesit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. • Urdhri nr. 343, datë 19.08.2013 “Për miratimin e Dispozitave Normative për arsimin parauniversitar (DN)”. • Udhëzimi nr. 16, datë 31.07.2017 për vitin shkollor 2017-2018, në sistemin arsimor parauniversitar. • Udhëzimi nr. 44, datë 16.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 23.07.2010 “Për normat e punës mësimore-edukative dhe numrin e nxënësve për klasë në institucionet e arsimit parauniversitar”. • Udhëzimi nr. 1, datë 20.01.2017 “Për funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”. • Udhëzimi nr. 2, datë 12.02.2015. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”. • Udhëzimi nr. 34, datë 11.09.2015 “Për vlerësimin e nxënësve për kurrikulën me kompetenca, në arsimin bazë”. • Udhëzimi nr. 14, datë 28.07.2016 “Për

	<p>vlerësimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Standardet e shkollës si qendër komunitare. • Urdhri Nr.6, datë 10.01.2018 për zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.
--	--

FUSHA: PROGRAMET LËNDORE TË GJEOGRAFISË

Kompetenca	Literatura e rekomanduar
Zbatimi në mënyrë efektive i programeve të gjeografisë në shkollë	
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • zbaton programin duke respektuar të gjitha kërkesat dhe rubrikat e tij; • përshtat programin lëndor në përputhje me veçoritë e mjedisit në të cilin jep mësim; • përdor me efikasitet, në dobi të prirjeve bashkëkohore, fleksibilitetin e zbatimit të programit; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve dhe aftësive të parashikuara në program; • gjen ose harton materiale plotësuese kurrikulare që pasurojnë formimin e nxënësve dhe nxitin mendimin e pavarur dhe kritik të tyre; • harton objektiva për tema mësimore ose grup temash, kapitujsh, në përputhje me objektivat e programit; • harton objektiva specifike që u përgjigjen niveleve të ndryshme të nxënësve; • tregon koherencën vertikale të kurrikulës (vazhdimësia dhe përshtatshmëria e programeve të gjeografisë); • përzgjedh mjetet mësimore të nevojshme për të 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza kurrikulare, 2014 • Kurrikula bërthamë AMU, klasat VI-IX, 2014 • Kurrikula bërthamë AML, klasat X-XII, 2016 • Programet me kurrikulën e bazuar në kompetenca klasat VI,VII,VIII dhe klasat X,XI.

<p>realizuar përmbushjen e objektivave të programit;</p> <ul style="list-style-type: none"> • siguron informacion që demonstroi lidhjen e gjeografisë me shkencat e tjera dhe me jetën reale. 	
--	--

**FUSHA: ASPEKTE TË PEDAGOGJISË, METODOLOGJISË DHE PËRDORIMIT TË TIK-ut
NË MËSIMDHËNIE-NXËNIE**

Kompetenca I	Literatura e rekomanduar
Zotërimi i njohurive pedagogjike specifike të nevojshme dhe të mjaftueshme për mësimdhënien e gjeografisë	
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • demonstroi përkushtim, motivim dhe përgjegjësi gjatë punës së tij; • përshtat punën e tij me zhvillimin fizik, social, emocional dhe konjitiv të nxënësve; • demonstroi respekt, besim dhe objektivitet me nxënësit; • identifikoi nxënësit me nevojë të veçanta (nxënësit me vështirësi në të nxënë dhe nxënësit e talentuar); • planifikoi punën afatshkurtër dhe afatgjatë me nxënësit me nevojë të veçanta; • demonstroi qëndrim pozitiv ndaj lëndës së gjeografisë; • motivoi nxënësit duke e konsideruar motivimin një nga çelësat e progresit të tyre; • të krijojë klimë të përshtatshme, motivuese dhe të kënaqshme për nxënësit; • punon me prindërit për përmirësimin e progresit të nxënësit. 	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. • Literaturë që ka në fokus aspekte pedagogjike të punës së mësuesit me nxënësit e tij.

Kompetenca II Përdorimi i metodave dhe strategjive efektive në mësimdhënien e gjeografisë	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • përzgjedh metodat dhe teknikat e përshtatshme për arritjen e një objekti të caktuar; • përdor metoda e teknika që nxisin mendimin e pavarur e krijues të nxënësve; • planifikon një orë mësimore duke u bazuar në mësimdhënien me në qendër nxënësin; • përdor metoda e teknika që nxisin zhvillimin e të menduarit kritik e krijues të nxënësve; • përdor metoda e teknika që sigurojnë barazinë dhe gjithëpërfshirjen; • dallon llojet e ndryshme të pyetjeve në një test; • identifikon gabimet në një pyetje objektive; • demonstroi teknika të ndryshme për vlerësimin e nxënësit; • përdor pikëzimin korrekt të pyetjeve në një test; • realizon konvertimin në notë të pikëve të një testi. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të nxënit me situata, kompetenca dhe situata e të nxënit, IZHA, 2014. • Korniza e vlerësimit të nxënësit, MAS, 23.07.2015. • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në arsimin e mesëm të ulët, 2017 • Udhëzuesi i zhvillimit të kurrikulës në gjimnaz 2016. • Nivelet e arritjes (arsimi bazë dhe arsimi i mesëm), IZHA, 2016. • Portofoli i të nxënit, IZHA, 2015. • Literaturë që ka në fokus metodat e mësimdhënies ndërvepruese, me në qendër nxënësin, metodologjinë e mësimdhënies së gjeografisë.
Kompetenca III Përdorimi i teknologjinë së informacionit dhe komunikimit për të rritur cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies në gjeografi	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • prezanton materiale gjeografike duke përdorur teknologji të përshtatshme si: Power Point, Excel dhe Word; • nxit nxënësit të bëjnë prezantime në gjeografi duke përdorur programe 	<ul style="list-style-type: none"> • Tekste nxënësi apo materiale në ndihmë të mësuesit të lëndës së gjeografisë që përdoren në klasat VI,VII,VIII të arsimit të mesëm të ulët si dhe në klasat X,XI të arsimit të mesëm të lartë dhe kanë në fokus përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie -nxënie.

<p>kompjuterike të njohura për ta;</p> <ul style="list-style-type: none"> • përfshin nxënësit në projekte kurrikulare të lëndës së gjeografisë apo në projekte kurrikulare të integruara të cilat ndërthurren me kërkime, gjetje dhe përdorime materialesh nga website. 	
--	--

FUSHA: ASPEKTE TË ETIKËS DHE KOMUNIKIMIT

Zbatimi i rregullave të etikës dhe komunikimit si elemente të domosdoshme në të gjithë punën e mësuesit	Literatura
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njih rregullat e etikës dhe sjelljes që duhen respektuar në marrëdhënie me drejtuesit e institucionit arsimor, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin; • sillet në përputhje me rregullat e etikës dhe të sjelljes në marrëdhënie me drejtuesit, stafin pedagogjik, nxënësit, prindërit dhe komunitetin gjatë punës së tij brenda dhe jashtë institucionit arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Kodi i Etikës së mësuesve në arsimin parauniversitar. • Draft Standardet profesionale të mësuesit në arsimin parauniversitar, IZHA, 2016. • Literaturë dhe materiale burimore që trajtojnë çështje të etikës dhe të komunikimit.

FUSHA: ASPEKTE TË DREJTSHKRIMIT TË GJUHËS SHQIPE

Zbatimi i rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe	Literatura
<p>Rezultatet e pritshme</p> <p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • njih rregullat e drejtshkrimit të standardit të gjuhës shqipe; • demonstroi zbatimin e rregullave të drejtshkrimit gjatë veprimtarive në institucionin arsimor. 	<ul style="list-style-type: none"> • Drejtshkrimi i gjuhës shqipe.

FUSHA: PËRMBAJTJA SHKENCORE E LËNDËS

Kompetenca Respektimi i rigorozitetit shkencor në mësimdhënien e lëndës së Gjeografisë	Literatura e rekomanduar
<p><i>Mësuesi i gjeografisë:</i></p> <ul style="list-style-type: none">• shpjegon konceptet kryesore me të cilat operon lënda e gjeografisë;• interpreton lidhjet shkak-pasojë midis proceseve e dukurive që trajton kjo lëndë;• demonstroi lidhjen midis njohurive të lëndës me njohuritë e disiplinave të tjera brenda fushës ose jashtë saj;• tregon përmes shembujve lidhjen e njohurive të kësaj lënde me situata të jetës së përditshme.• shpjegon dhe interpreton konceptet, fenomenet dhe informacionin që trajtohet në lëndën e gjeografisë në klasat VI-IX dhe X-XII.	<ul style="list-style-type: none">• Programe dhe tekste të lëndës për mësuesin dhe nxënësin, si dhe materiale të tjera burimore që mbulojnë përmbajtjen e lëndës së gjeografisë në arsimin parauniversitar.